

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kosova është Serbi"/ Vuçiç nuk ndryshon qëndrim. Ankohet në OKB për NATO-n, sulmon Kroacinë
ADRESA	https://versus.al/bota/kosova-eshte-serbi-vucic-nuk-ndryshon-qendrim-ankohet-ne-okb-per-nato-n-sul-i47094
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 15:40:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 15:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	386bf40649a863bc94b94a3277a112712455c1651fb75a9f99477ff17635172d
TEKSTI	8b73ff7e98f655b8f4f45b8b0ca49586ee434ada9af8468673d9b2845cae222a
PAMJA	1d2fa4c5f39a3cb21e87512dff0d7b3a518c5a17e7496367d29f5b3a5ec1b1e2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	46b5be403b12f86a89d271dedfe430a2bf5b8c264904ab2ed5a13543ec8fc856
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c206ef00f3c5688ec3d6505e364edf4e33bce2ceb75a58f689bcce7e176545ba
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/46b5be403b12f86a89d271dedfe430a2bf5b8c264904ab2ed5a13543ec8fc856>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Vlora Hyseni lihet në arrest shtëpie, ish-shefja e SHISH "kyç" gojën para gazetarëve. GJKKO nuk publikon vendimin deri në fund të hetimeve](#)

24 Shtator 2026, 14:07

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në


-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[BOTA](#) / 24 Shtator 2026, 17:29

"Kosova është Serbi"/ Vuçiç nuk ndryshon qëndrim. Ankohet në OKB për NATO-n, sulmon Kroacinë

Vuçiç deklaroi se Serbia do të mbrojë integritetin territorial dhe sovranitetin e saj, ndërsa falënderoi 107 shtetet që, sipas tij, nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.





Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka përsëritur qëndrimin e Beogradit për Kosovën gjatë fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Vuçiç deklaroi se Serbia do të mbrojë integritetin territorial dhe sovranitetin e saj, ndërsa falënderoi 107 shtetet që, sipas tij, nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

“Dua të falënderoj secilin prej 107 vendeve që nuk e njohën pavarësinë e shpallur në mënyrë të njëanshme të të ashtuquajturës Kosovë”, tha Vuçiç.

Presidenti serb kritikoi ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999, duke pretenduar se arsyeja e deklaruar për sulmin ndaj Serbisë ishte shmangia e një katastrofe humanitare.

“Arsyeja e vetme zyrtare për sulmin ndaj Serbisë, të kryer nga 19 vende të NATO-s, është se ata na thanë se e sulmuan vendin për të shmangur një katastrofë humanitare. Kjo nuk ndodhi”, u shpreh ai.

Vuçiç akuzoi gjithashtu vendet që njohën Kosovën se kanë dëmtuar rendin ndërkombëtar dhe parimet e Kartës së OKB-së.

“Rendi i Kartës së së drejtës ndërkombëtare nuk ekziston më. Ata e shkatërruan atë për shkak të interesave të tyre politike”, deklaroi presidenti serb.

Duke folur për dialogun Kosovë-Serbi, Vuçiç iu referua Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013. Ai pretendoi se Serbia ka përbushur detyrimet e saj, ndërsa Kosova nuk ka zbatuar pjesën që lidhet me formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

Në fund të fjalimit, presidenti serb u ndal edhe te Kroacia. Ai pretendoi se në këtë shtet po rikthehen në hapësirën publike simbole dhe slogane të lidhura me nazizmin.

“Është më e vështirë për ne në Serbi kur, në mjedisin tonë, shohim nazizmin të ngrihet përsëri në pedestalin e vlerave shoqërore, veçanërisht në Kroaci”, tha Vuçiç.

Fjalimi i presidentit serb në OKB vjen në një kohë kur çështja e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë vijon të mbetet një nga çështjet kryesore në agjendën ndërkombëtare për Ballkanin Perëndimor./Versus.al

Poll



BOTA

[Sondazhi në Itali/ Bie vlerësimi pozitiv për qeverinë Meloni, 59% shprehen të pakënaqur](#)

24 Shtator 2026, 17:10

^ekstrakti^





BOTA

Sulm kibernetik ndaj FBI-së? Nis hetimi për vjedhje të të dhënave të agjentëve

24 Shtator 2026, 16:57

^ekstrakti^



BOTA

Tragjike në Australi/ Nëna vret djalin 5-vjeçar dhe plagos dy fëmijët e tjerë me thikë brenda në makinë

24 Shtator 2026, 15:09

^ekstrakti^



BOTA

"Mos u ngatërroni me të", Trump për Erdoganin: Ai është shumë i fortë

24 Shtator 2026, 11:35

^ekstrakti^



BOTA

Tre vite nga vdekja e heroit Afrim Bunjaku në sulmin terr*rist në Banjskë, sot mbahen homazhe në Kosovë

24 Shtator 2026, 10:06

^ekstrakti^




BOTA

[Trump i kërcënoi me asgjësim, presidenti iranian në OKB: Nuk përulemi kurrë ndaj sulmeve tuaja frikacake](#)

24 Shtator 2026, 08:37

^ekstrakti^



BOTA

[Rusia godet me dronë godinën e partisë së Zelenskit, kur ai fliste në OKB](#)

23 Shtator 2026, 21:32

^ekstrakti^



BOTA

[Melanie Trump i bie ziles në Wall Street, para fjalës në Samitin e parë global të grave sipërmarrëse](#)

23 Shtator 2026, 21:13

^ekstrakti^

[Të fundit](#)





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.